



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**



**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

### **Debat publik për Dëgjimet Buxhetore për vitin 2024 - Fshati Orllan**

---

Debati i tretë publik për Dëgjimet Buxhetore për vitin 2024 u mbajtë në fshatin Orllan. Në vazhden e këtij diskutimi hyn edhe projekcioni buxhetor për vitin 2025 dhe 2026. Në këtë debat publik pjesëmarrës nga ekzekutivi komunal ishte drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani, drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bahri Selimi dhe drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit, Alban Zeka .

Debatin Publik e hapi drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani duke iu uruar miëseardhje të pranishmëve.

Drejtori Osmani ka theksuar që Komuna e Podujevës ka filluar hartimin e projekt buxhetit për vitin 2024, ku ka paraqitur një rezyme të përgjithshme të buxhetit dhe limiteve buxhetore të cilat i ka Komuna e Podujevës, në bazë të qarkores së dytë buxhetore të pranuar nga ana e Ministrisë së Financave. Komuna e Podujevës ka një buxhet të përgjithshëm prej 31 milion e 43 mijë e 19 euro. Nga kjo shumë 16 milion e 518 mijë e 288 euro janë në kategorinë e pagave, 513 mijë euro janë shpenzime për komunalitë do të thotë, rrymë, ujë dhe mbeturina. 1 milion e 670 mijë euro janë në kategorinë e subvencioneve dhe 8 milion e 756 mijë euro janë buxhet i planifikuar për investime kapitale të Komunës së Podujevës.

Drejtori Osmani, gjithashtu ka bërë krahasimin e buxhetit të vitit 2021 që ka qenë 23 milion euro, ndërsa tani kemi një buxhet prej 31 milion euro, pra një buxhet prej 8 milion euro më i lartë.

Gjatë këtyre viteve, Komuna e Podujevës i ka disa dokumente të hartuara siç është Strategjia e Zhvillimit Ekonomik dhe Korniza Afatmesme Buxhetore, ku në bazë të këtyre dokumenteve janë prioritzuar disa sektorë të cilët janë konsideruar jetikë për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Komunës së Podujevës, siç janë arsimiti, shëndetësia, bujqësia dhe kultura. Ndërkaq, tek investimet kapitale për ndërtimin e rrugëve dhe kanalizimeve kemi një rritje të buxhetit, ku nga 6 milion e gjysmë euro që ka qenë në buxhetin 2021, tani jemi tek një buxhet prej 8 milion e 756 mijë euro, afër 2 milion euro më i lart se vitet paraprake.

Drejtori Osmani, ka theksuar se qëllimi i këtyre debateve publike është inkuadrimi i të gjitha kërkesave të banorëve të këtyre lokaliteteve në projekt buxhetin për vitin 2024, si dhe ua kaloi fjalën të pranishmëve.

Naim Bajrami- Drejtor i Shkollës së Orllanit- Ka kërkuar rregullimin e çatisë, rrethojat e objektit të shkollës, ndërtimin e një fushe sportive, rregullimin e një këndi të lojrave, izolomi i jashtëm i shkollës, ku këtu hyjnë edhe 5 hyrjet e shkollës, më pas kërkesë është edhe rregullimi i kalldajës së shkollës, si dhe të mbjellen drunjë dekorativ në oborrin e shkollës.

Arben Musa- Përfaqësues i rrethinës së Orllanit- Ka paraqitur të gjitha kërkesat e banorëve, ku kërkon asfaltimin e rrugëve të fshatrave Kushevicë-Nishefc, Orllan- Rakinicë, në lagjen Kongajjt, Orllan-Muhazob, po ashtu kërkon asfaltimin e rrugës “Raguza” në fshatin Bërvenik, vazhdimi i asfaltit në fshatin Brainë, tek varrezat e familjes Beka dhe Salihu. Gjithashtu, ka kërkuar edhe trajtimin e disa rrugëve me zhavor, si rruga “Bajrush Sillova” në fshatin Kushevicë, rruga “Plepi i Nasovcit” në fshatin Muhazob, rruga “Jahë Bilalli” në fshatin Metërgofc, rruga nga shkolla e fshatit Turuqicë në drejtim të fshatit Herticë, si dhe rruga nga shkolla e Turuqicës deri tek xehrorja, rruga në lagjen e familjes Kamberi deri tek fushat e Kalaticës, rruga “Qafa e Plepit” që është rrugë lidhëse mes fshatit Orllan dhe Ballaban, rruga “Te Quka e Brainës”, lagjia Sherifi dhe Haliti. Ndërkaq, ka kërkuar që të vendosen disa pengesa apo anësore si në rrugën “Rasim Zeka” në fshatin Metërgofc, në rrugën “Zenel Tora” që është rrugë lidhëse mes fshatit Orllan- Ballaban, rruga “Hajdin Haliti”. Më pas, kërkon mirëmbajtjen e rrugës Orllan-Brainë dhe rregullimin e kanalit të ujëmbledhësit për rreth rrugës.

Safet Deliu- Banor i rrethinës së Orllanit- Ka pyetur drejtorin Osmani se cila është vlera e saktë e investimeve kapitale për rrethinën e Orllanit, si dhe ka kërkuar asfaltimin e rrugës Orllan- Bllatë.

Valbona Ibishi- Banore e fshatit Orllan- Ka kërkuar nga Komuna të vendosen policë të shtrirë në rrugën e fshatit Orllan, afër shkollës. Po ashtu, ka kërkuar vazhdimin e trotuarit afër urës së fshatit Orllan, si dhe ka kërkuar të vazhdohet ndriçimi publik deri të kulla e Zahir Pajazitit.

Latif Shabani- Banor i fshatit Orllan- Ka kërkuar nga Komuna të ndërhyjnë në rregullimin e rrugës Orllan-Bllatë-Metërgofc.

Bahri Retkoceri- Banor i fshatit Bllatë- Ka kërkuar të inkuadrohet në projekt buxhetin e Komunës asfaltimi i rrugës në fshatin Bllatë.

Sylë Ahmeti- Banor i fshatit Brainë- Ka ngritur si kërkesë asfaltimin e rrugës “Behram Bislimi”, ku është e pregaditur për asfaltim që nga viti 2015, por që nuk është përfunduar ende.

Adem Munishi- Banor i fshatit Orllan- Kërkon nga Komuna të asfaltohet rruga “Rubiku” në fshatin Orllan.

Sylejman Rrahmani- Banor i fshatit Turuqicë- Kërkon të inkuadrohen në projekt buxhetin për vitin 2024 të asfaltohet rruga lidhëse mes fshatit Turuqicë- Herticë, gjithashtu edhe rruga lidhëse me xehrore dhe të asfaltohen rrugët e lagjeve “Bregu i Madh”, “Siarina” dhe “Rexhep Terpeza”. Ndersa, kërkon edhe shtrirjen e rrjetit të ujësjellsit dhe energjisë elektrike për shtëpi banimi.

Vehbi Abdullahu- Banor i fshatit Brainë- Kërkon mirëmbajtjen e rrugës lidhëse mes fshatit Orllan- Brainë dhe të pastrohen atmosferikët afër rrugës kryesore. Po ashtu, kërkon asfaltimin e rrugës “Quka e Zhigut”, kërkon gjithashtu rrugë lidhëse mes lagjes Gubavcëve bashkë me lagjen e Rafunëve, në fshatin Nishec, kërkon asfaltimin e rrugës nga xhamia e fshatit deri te “Quka e Brainës”. Ndërkaq, Abdullahu ka kërkuar, rregullimin e dritareve të shkollës së fshatit Brainë, rregullimin e xhamisë dhe të bëhet mirëmbajtja e varrezave të fshatit.

Banor i fshatit Brainë- Ka kërkuar që shkolla e vjetër e fshatit Brainë të vihet në mbrojtje si trashëgimi kulturore dhe të bëhet renovimi i xhamisë së vjetër. Gjithashtu, kërkon të asfaltohet rruga lidhëse mes fshatit Brainë dhe fshatit Nishec.

Hilmi Dalipi- Banor i Orllanit- Kërkon të bëhet investime ne infratrakturë rrugore, si dhe kërkon asfaltimin e rrugës mbrapa ambulantsës së fshatit.

Osman Bilalli- Banor i fshatit Metrgofc- Kërkon asfaltimin e rrugës në lagjen Bilalli, në fshatin Metërgoc.

Halil Munishi- Banor i fshatit Turuqicë- Kërkon shtrirjen e rrjetit të energjisë elektrike në lagjen e familjes Dibrani, Siarina dhe Dervisholli.

Samir Gjela- Banor i fshatit Brainë- Kërkon asfaltimin e rrugëve lidhëse “Ismajl Gjela” dhe “Remzi Fetahu” në fshatin Brainë.

Shemsi Hajdini- Banor i fshatit Turuqicë- Kërkon shtrirjen e rrjetit të energjisë elektrike dhe asfaltimin e rrugës në lagjen Brejshërve.

Banor i fshatit Orllan- Ka kërkuar nga Komuna shtrirjen e rrjetit të ujësjellsit në rrethinën e Orllanit, si dhe kërkon të bëhet hartimi i planit të ndërtimit të sheshit në fshatin Orllan.

Naser Avdiu- Banor i fshatit Turuqicë- Kërkon asfaltimin e rrugës “Rexhep Tërpeza”.

Ismajl Sejdiu- Banor i rrethinës së Orllanit- Kërkon shtrirjen e rrjetit të ujësjellsit.

Muharrem Dili- Banor i fshatit Orllan- Kërkon rregullimin e kanalizmit të rrugës “Ekrem Dili”, si dhe kërkohet asfaltimi i rrugës deri te pllaka perkujtimore e dëshmorit Ekrem Dili.

Hasan Hoxha- Banor i rrethinës së Orllanit- Kërkon të ndërtohet një fushë sportive në rrethinën e Orllanit.

Naim Jashari- Banor i fshatit Orllan- Kërkohet nga Komuna të inspektohen puntorët shëndetësorë për orarin e punës.

Ilmi Shabani- fshati Kushevicë- Kërkon asfaltimin e rrugës “Bajrush Sillova”.

Përfaqësues i fshatit Rakinicë- Kërkon asfaltimin e rrugës në fshatin Rakinicë me gjatësi 3.5km.

Safet Deliu- Banor i rrethinës së Orllanit- Ka ngritur kërkesat për infrastrukturë rrugore, ku kërkohet mirëmbajtja e trotuarit dhe ndriqimit të rrugës nga trafoja deri tek kulla, me gjatësi 2.1km, si dhe kërkon të bëhet ndërtimi i trotuarit të rrugës “Hajdin Haliti”.

Avni Avdiu- Përfaqësues i Komitetit jo-shumicë- Kërkohet rregullimi i trotuarit tek ura e fshatit Orllan dhe ndërtimin e një këndi të lojrave për fëmijë.

Rexhep Zeka- Banor i fshatit Orllan- Ka kërkuar nga Komuna që të gjitha kërkesat që janë ngritur nga banorët e rrethinës së Orllanit të vihen në prioritet, si dhe pjesa e turizmit të jetë prioritet për Komunën.

Ismet Halimi- Banor i fshatit Orllan- Ka ngritur shqetësimet për infrastrukturë rrugore dhe ndriqim publik.

Sqarimin për kërkesat e banorëve e filloi drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bahri Selimi, duke thënë se kërkesat që paraqiten në Komunë, të gjitha shqyrtohen, po që është e pamundur të realizohen brenda një viti. Ku, ka filluar me kërkesën për shkollën në fshatin Orllan, e që ka treguar se është shqyrtim që të hyjë në planin buxhetor për vitin e ardhshëm renovimi i jashtëm dhe i brendshëm i shkollës. Ndërsa, sa i përket infrastrukturës rrugore, drejtori Selimi, ka thënë se të gjitha kërkesat e ngritura nga banorët do të adresohen në drejtoritë përkatëse dhe në bazë të mundësive do t'i inkorporojmë në projekt buxhet për vitin e ardhshëm. Kurse, për rrugën e fshatit Bilatë dhe rrugën “Ekrem Dili”, drejtori ka treguar se janë trajtuar pjesërisht me zhavor, por për shkak të reshjeve atmosferike janë dëmtuara rrugët e intervenuara. Për rrugën e fshatit Kalaticë dhe rrugën e fshatit Brainë, “Shaban Dërguti” ka treguar se këtë vit do të trajtohen me zhavor me kontratën aktuale. Për sigurinë e rrugës nga fshati Luzhan në drejtim të fshatit Orllan ka thënë se është rrugë regjionale, por në bashkëpunim me nivelin qendror në disa raste vendosim trotuare, por sa i përket mirëmbajtjes së rrugës dhe rregullimit të urave është kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës, ndërsa për trotuarin e urës së fshatit Orllan ka treguar se është duke u shqyrtu mundësia për rregullimin e trotuarit me një konstruksion të hekurit, ku kemi bërë kërkesë në Ministri të Infrastrukturës. Ku, gjithashtu edhe për ndriçim publik është bërë kërkesë në ministri.

Drejtori Selimi ka thënë se shqetësim i kahmotshëm për rrethinën e Orllanit është shtrirja e ujësjellsit dhe kanalizimit. Ndërtimi i ujësjellsit në fshatin Orllan ka filluar nga viti 2018 me një projekt të Ministrisë dhe KRU Prishtina, ku Komuna e Podujevës ka bërë hartimin e projektit me vlerë prej 22 mijë euro, por që ende nuk ka përfunduar edhe pse kemi bërë shumë kërkesa përmes email-it. Po ashtu, drejtori Selimi tha se problem tjetër është kanalizimi ku edhe për këtë pjesë do të bëjmë kërkesë në Ministrinë e Infrastrukturës për zgjedhjen e problemit.

Gjithashtu për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit për Orllanin dhe fshatrat për rrethë drejtori Selimi ka treguar se janë në proces të një bashkëpunim mes nivelit qendror dhe KRU Prishtina. Ku ka

treguar se Ministria i ka ndarë 150 mijë euro, Komuna i ka ndarë 60 mijë euro, ndërsa KRU Prishtina i ka ndarë mbi 200mijë euro.

Po ashtu, për Planin Arsimor-Zhvillimor në rrethinën e Orllanit drejtori Selimi ka thënë se kemi kërku nga Ministria të na ipet e drejta të përpilojmë një plan zhvillimor, ku atë plan do ta paraqesim në Ministri, më pas Ministria do të ndërmarrë hapa, por që nuk ka asgjë konkrete.

Naim Bajrami- Drejtor i Shkollës së Orllanit- Ka paraqitur kërkesë për rregullimin e një grope septike të ujrave të zeza që është e hapur afër shkollës.

Drejtori Selimi për gropën septike ju ka thënë se si komunitet duhet ta drejtoni këtë kërkesë në Komunë, pastaj Komuna e adreson në Ministrinë e Administrimit dhe Pushteti Lokal.

Kurse, për kërkesa të tjera ju ka thënë që si Komunë jemi të hapur të mirëpresim kërkesat edhe përmës email adresës elektronike dhe sipas mundësive do t'i inkuadrojmë në projekt buxhetin e viti 2024.

Ndërkaq, drejtori Osmani i ka falenderuar për diskutimin, si dhe për vlerën e buxhetit të ndarë për vitin 2024 për rrethinën e Orllanit ka thënë se nuk e kemi të ndarë buxhetin, mirëpo do të veprojmë sipas prioriteteve të caktuara që i kemi si Komunë.

Drejtori Alban Zeka për çështjen e mbeturinave ka treguar për disa takime që janë mbajtur për një formatim të ri për mënyrën e trajtimit të mbeturinave, për shkak që ekziston një shpërputhje shumë e madhe mes data bazës së KEDS-it dhe asaj të kompanisë regjionale Pastrimi, si dhe ka kërkuar bashkëpunim nga qytetarët për raportim të banorëve të cilët nuk janë në regjistër të pagesës së mbledhjes së mbeturinave. Ndërsa, në lidhje me Planin Hapsinor ka dhënë sqarime për vendimin e vitit 2013, i cili ndahet në tri zona të mbrojtura, prandaj edhe me patjetër duhet të ndërhyjmë në ato zona të mbrojtura në të cilën fillon ndërtimi.





32 pjesëmarrës nga fshati Orllan me rrethinë

**25 Gusht / Fshati Orllan**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Dëgjim Publik në fshatin Orllan për projekt buxhetin e komunës për vitin 2024 -  
Lista e nënshkrimeve

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nr.telefonit	Nënshkrimi
1	AR BEN MUSA	ORLLAN		
2	Rexhep Zeka	ORLLAN		
3	SAFET DELIU	ORLLAN		
4	Volbona Thishi	ORLLAN		
5	Norim Bajrami	Orllan		
6	LATI F Hoxha	ORLLAN		
7	Ignjet Gheza	Orllan		
8	Sejdi Zuka	ORLLAN		
9	Arifullah Habani	ORLLAN		
10	Ismael Sejdu	Orllan		
11	Sulejman Rahmani	TURUGIC		
12	Edi Priz	Orllan		
13	ISAK SHABANI	ORLLAN		
14	Milazim Sejdu	ORLLAN		
15	Shamir Shqollari	TURUGIC		
16	Redon Gashi	Orllan		
17	Selvi Ahmeti	BARAJNE		
18	ADEM MUMISHI	ORLLAN		
19	Osman Bilalli	METEKOFA		
20	Qamil Zeka	METEKOFA		
21	Elmi Shapuri	RUSOVIC		
22	Fatmir Sullami	RUSHEVIC		
23	DRITON ZANUZI	ORLLAN		
24	Blaz Mehmeti	TURUGIC		



25	Vehli Belm DJALI	Brain	
26	ENVER OERGUTI	BRAIN	
27	Adnan Germani	JUSHEVIC	
28	SAMIA ZECA	SKOLIC	
29	BEHAG JASHAN	ORLAN	
30	Jasp Degen	ORLAN	
31	AVNI AVDIM	ORLAN	
32	BILAL ZECA	RATINIC	
33			
34			
35			

Orllan

24.08.2023